

GYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, Trupi gjykues në përbërje nga gjyqtarët: Bashkim Hyseni, kryetar i trupit gjykues, Musa Konxheli dhe Zenel Tasholli, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ardrita Ymeri, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.D. për veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par. 1 të KPRK-së, dhe H.A. për veprën penale ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda : PP/I.nr. 63/13, të datës 12 shtator 2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 02 dhe 06 dhjetor 2013, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit të shtetit Rasim Maloku, të akuzuarve E.D. dhe H.A., mbrojtësit të të akuzuarve, avokat B.H. dhe A.I., të dëmtuarës S.B., mbrojtësit të viktimave Ibrahim Tërstena, mori dhe komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- 1. E.D.**, nga i ati G. dhe e ëma L., e vajzërisë K., data e lindjes, në Berat, Republika e Shqipërisë, me vendbanim në Tiranë, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, me numër personal të pasaportës ... i martuar, nuk din shkrim dhe lexim, nuk ka të kryer shkollën fillore, i gjendje së varfër ekonomike, i cili gjendet në paraburgim nga data 18.04.2013, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.
- 2. H.A.**, nga i ati E., dhe e ëma E., e vajzërisë F., data e lindjes, në Ferizaj, me vendbanim në rrugën “.....” nr:, në Ferizaj, me numër personal të letërnjoftimit:, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion hotelier, i martuar din shkrim dhe lexim, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, gjendet në paraburgim nga data 18.04.2013 deri më 16.09.2013.

I

SHPALLEN FAJTOR

I/1 I akuzuari E.D. :

Sepse :

Nga 15 shkurt 2013 deri më 18 prill 2013, në Ferizaj ka kontrolluar të dëmtuarën S.B. me qëllim të prostitucionit në atë mënyrë ka bashkëjetuar me të dëmtuarën në banesën që e mbante me qira, e pastaj i ka mundësuar që të punoj si valltare-kameriere në “D.P.H. ...” në Ferizaj, në të cilën i akuzuari i dytë ushtronte veprimtari hoteliere, e me qëllim që ti mundësoj ushtrimin e prostitucionit kështu që e dëmtuara gjatë kohës së punës bënte marrëveshje me klientët në këtë lokal kurse pas përfundimit të orarit të punës rreth orës 24:00, i akuzuari E. i siguronte veturën taksit që ta dërgoj deri te restoranti “...” që gjendet në Ferizaj afër rrugës magjistrale, në të cilin restorant e dëmtuara ka ofruar shërbime seksuale me pagese për 50 (pesëdhjetë) €, me disa klientë dhe atë me datë 15 shkurt 2013, me klientin M.Z., me datë 15 dhe 16 shkurt 2013, si dhe 2 mars 2013 me klientin S.Sh., e me datë 13 mars 2013, me klientin B.G., me datë 18 dhe 25 mars 2013, me klientin H.D., dhe me datë 22 mars 2013, me klientin Z.LL.1, kurse paratë e fituara i shfrytëzonin bashkërisht me të dëmtuarën.

- me të cilën ka kryer veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.1 të KPRK-së.

I/2 I akuzuari H.A.:

Sepse :

Nga 15 shkurt deri më 25 mars 2013 në Ferizaj si pronar i lokalit DPH “...” me dijëni ka ofruar lokalin për të mundësuar ushtrimin e prostitucionit, në atë mënyrë që ka punësuar viktimën S. për të punuar kinse si kameriere-valltare, me qëllim që e njëjta gjatë

orarit të punës të ulet me klient në tavolinë për ti shoqëruar gjatë qëndrimit në këtë restorant për të paguar çmim më të lartë për pije si dhe për të bërë marrëveshje për të ofruar shërbime seksuale me pagesë pas përfundimit të orarit të punës, e të cilat shërbime e dëmtuara i kryente në restorantin “...” siç përshkruhet në dispozitivin e parë,

- me të cilën ka kryer veprën penale ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 par.1 të KPRK-së.

Konform 365 të KPPRK-së, dhe dispozitave të nen 7, 17, 21 par. 2, 41, 42, 43, 45, 46, 62, 66, 71, 73, 74, 83 të KPRK-së i:

G J Y K O N

Të akuzuarin E.D., dënim burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18 prill 2013 e tutje, si dhe Dënim me Gjobë në Lartësi prej 1200 (njëmijë e dyqind) €.

Dënimin me gjobë të shqiptuar është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20 (njëzetë) € do të vuaj 1 (një) ditë burgu.

I shqiptohet dënim plotësues dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës, dhe atë në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Koha e mbajtur në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

E dëmtuara S. B. nuk ka paraqitur kërkesë pasurore- juridike.

Obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit H.A., dënim burgimi në kohëzgjatje prej 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy ditë) , në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 18 prill 2013, deri më 16 shtator 2013, dhe me Dënim me Gjobë në lartësi prej 1200 (njëmijë e dyqind) €.

Dënimi me gjobë të shqiptuar është i obliguar që të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20 (njëzetë) €, do të vuaj një ditë burgu.

I shqiptohet dënim plotësues ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë hoteliere në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, duke e llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.63/13, të datës 12 shtator 2013, ka ngarkuar të akuzuarit E.D. për veprën penale trafikimi me qenie njerëzore nga neni 171 par. 1 të KPRK-së dhe të akuzuarin H.A., për veprën penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale për të cilën akuzoheshin, ndërsa në afatet për paraqitjen e kundërshtimeve kundër aktakuzës nuk kanë paraqitur.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 2 dhe 6 dhjetor 2013, në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Rasim Maloku, ka deklaruar se bënë rikualifikimin juridik të veprës penale duke e akuzuar të akuzuarin E.D., për veprën penale mundësimi ose detyrimi në

prostitucion nga neni 241 par.1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht bërë ri përshkrimin faktik të dispozitivit të akuzës që i referohet këtij të akuzuari si në dispozitiv të aktgjykimit. Ndërsa për të akuzuarin H.A., ka qëndruar pranë kualifikimit juridik fillestar për veprën penale ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 par.1 të KPRK-së, duke propozuar trupit gjykues që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të ju shqiptohet dënim i paraparë sipas ligjit.

Gjithashtu ka propozua që konform nenit 62 par.1 dhe 2 pika 2.9 të KPRK-së, të akuzuarit E.D. ti shqiptohet dënimi plotësues dëbimi nga territori i Republikës së Kosovës pasi që i njëjti është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe qëndrimi i tij i mëtutjeshëm në Kosovë do ti mundësonte vazhdimin e kryerjes së veprës penale. Ndërsa për të akuzuarin H.A. ka propozuar që trupi gjykues ti shqiptoj dënim plotësues nga neni 61 dhe 62 par.2.4 të KPRK-së, ndalimin e ushtrimit të profesionit përkatësisht veprimtarinë hoteliere për periudhën e caktuar kohore.

S.B., në cilësinë e të dëmtuarës në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se nuk ka arsye të akuzoj askënd se atë që e ka bërë e ka bërë për fëmijët e saj, dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike (dëshmia e të dëmtuarës do të trajtohet në pjesën e vlerësimit të dëshmive) .

Mbrojtësi i viktimave Ibrahim Tërstena në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështetë mendimin e prokurorit të shtetit në tërësi, nga provat dhe faktet të cila i elaboroj gjatë kësaj seance gjyqësore konsideron se janë të mjaftueshme për trupin gjykues që të akuzuarit i shpall fajtor për veprat penale për të cilat akuzoheshin dhe ti dënoj sipas ligjit.

I akuzuari E.D., është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se asnjëherë nuk e ka detyruar të dëmtuarën S. që të merret me ofrimin e shërbimeve seksuale, dhe as që e ka ditur se njëjta ka ofruar këto shërbime. Duke shpjeguar se me të dëmtuarën bashkëjeton dhe se është e palogjikshme që të njëjtën ta lejonte të merret me veprime të tilla, ka propozuar që të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.D., avokati B.H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara nuk janë provuar elementet e veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së, ngase nuk ka mundësuar, kontrolluar, ose detyruar të dëmtuarën për të ushtruar prostitucion, nuk është kontestuese se e dëmtuara të

gjitha marrëveshjet për kryerjen e aktit seksual në hotelin "...", i ka bërë vetë, dhe për sqarim të aktakuzës në bazë të dëshmisë së dëshmitarëve të cilët kanë dhënë në procedurën paraprake para policisë si dhe në seancën gjyqësore para trupit gjykues, të cilët kanë theksuar në mënyrë bindëse me marrëveshje më të dëmtuarën e kanë bërë direkt mes tyre, ashtu që i i akuzuari as që ka pas kontakt me ta, dëshmitarët edhe nuk e njohin të akuzuarin E.. E dëmtuara nuk mohon se është marrë me prostitucion por këtë e ka bërë në mënyrë vullnetare duke u bazuar nga gjendja materiale të cilën e kishte të dobët dhe fitimi i atyre parave nga prostitucioni i ka sjellur fëmijëve gjendje me të mirë të jetesës që gjenden në Tiranë. Andaj në mungesë të provave ka propozuar që të lirohet nga akuza për veprën penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari H.A., është deklaruar i pafajshëm, duke shtuar në mbrojtjen e tij se punon një kohë të gjatë merret me veprime hoteliere, dhe se S. ka qenë vetëm një punëtore e rregullt gjegjësisht kamarirere për të cilën i ka pasur të gjitha dokumentet në rregull përfshirë edhe kontratën e punës të cilën e ka paguar në shumë prej 400 (katërqind) €. Ndërsa nuk ka pasur fare dijeni se e dëmtuara kishte bërë marrëveshje për ofrimin e shërbimeve seksuale, me mysafirët e restorantit të tij. Ka propozuar që të lirohet nga akuza.

Mbrojtës i të i akuzuarit H.A., avokat A.I., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e prezantuara në shqyrtimin gjyqësor, përkitazi me të akuzuarin H.A. nuk vërtetohen theksimet e akuzës të përshkruar në dispozitivin e akuzës. I akuzuari H.A., nuk ka patur dijeni se punëtorja S. e cila ka qenë e punësuar si kameriere është marrë me ushtrimin e prostitucionit pas përfundimit të orarit të punës.

Gjatë orarit të punës punëtorja-kamerierja me dëshirën e mysafirëve ka mundur të ulet në tavolinën e tyre për ti shoqëruar dhe të konsumoj pije, në rast të tillë çmimi i pijes është më i lartë. Punëdhënësi-pronari i restorantit në atë rast nuk mund të kërkon nga punëtorët të informohet se për çka është biseduar me mysafirin.

Gjatë orarit të punës nuk dinë se që ka ndodhur ndonjë rast që e njëjta të largohet nga vendi i punës dhe të mungonte në kohë të caktuar. Pas mbarimit të orarit të punës zakonisht atë e ka pritur dhe shoqëruar personi E.D., me të cilin ka bashkëjetuar.

Prandaj, nuk qëndron theksimi se i akuzuari H. ka patur dijeni se S.B. ka biseduar dhe ka arritur marrëveshje që pas orarit të punës të takohen me mysafirët e caktuar për ofrimin

shërbimeve seksuale. Nuk ekzistojnë prova se i akuzuari H.A. ka kryer veprën penale ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 242 par.1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që të lirohet nga akuza.

Në shqyrtimin gjyqësor janë prezantuar dëshmitë dhe provat e prezantuara si vijon janë dëgjuar dëshmitarët e dëmtuara S.B., Xh.G., E.I., M.Z., ..., B.G., A.S.1, S.Sh. dhe Z.LL.2 .

Janë prezantuar provat : Raporti i masave të fshehta hetimore – përgjimi i telekomunikimit për numrat e telefonit: numri i të dëmtuarës: ..., numri i të akuzuarit E.D. ..., numri i taksistit E.I. Dokumentacioni i punësimit për të dëmtuarën S.B., leja e punës e lëshuara nga Ministria për Mirëqenie Sociale e Republikës së Kosovës. Raportet nga administrata tatimore për të akuzuarin H.A. dhe të dëmtuarën S.B., raportet financiare nga bankat komerciale të Kosovës për të akuzuarit.

Deklarimet e dëmtuarës dhe dëshmitarëve

E dëmtuara S.B., në cilësinë e dëshmitares ka deklaruar: Para një viti ka ardhur në Kosovë, së bashku me E., me të cilin ka bashkëjetuar dhe se arsyeja e ardhjes në Kosovë ishte për të punuar dhe kjo ishte, ngase në Kosovë kishte më shumë punë. Nuk ishte në dijeni nëse E. ka punuar më parë në Kosovë. Me të ardhur janë vendosur në një banesë dhe ka filluar të punon në kafiterinë "...", ku pronar ishte H.A., ku ka punuar si kamarierë dhe atë prej orës 12:00, deri në ora 24:00, zakonisht ka punuar 12 orë dhe për këtë paguhej 10 (dhjetë) € në natë, në Kosovë numri i telefonit të saj është ..., E. nuk bënte asgjë në atë kohë. Fëmijët i kishte tek ish-bashkëshorti i saj dhe i dërgonte të holla. Ka deklaruar se nëse ka gabuar me dikë tjetër, e kam bërë për evlat (fëmijët) e saj dhe jo se e ka shtyrë E. që të bëjë. Ka shkuar në restorant "...” 3 (tre) herë. E. nuk e ka ditur se ka shkuar në restorantin "...”, për të ofruar shërbime seksuale dhe shkuarjen në motel e bënte me taksitë, dhe jo me të njëjtin por i ndërronte, dhe kur mundej dhe si mundej e mashtronte burrin (të akuzuarin). Ka dal në kafiq është njohur me ta (me personat që ju ka ofruar shërbime seksuale me pagesë), duke ju dhënë numrin e telefonit me të cilët ishte takuar. Gjatë muhabetit, ju tregonte se ka fëmijë dhe i ndihmonin. Çmimi ishte 40 (katërdhjetë) €.

Duke shtuar se me E. nuk ka kurorë dhe se ka kaluar shumë mirë, pa probleme në harmoni dhe se E. në asnjë rast nuk i ka gjetur klient apo ndërmjetësuar dhe se shërbimet e

taksisteve i paguante vetë, shumë raste. Gjithashtu ka shpjeguar se ka punuar në mënyrë të rregullt, se pronari i restorantit i akuzuari H., nuk është ulur asnjëherë në tavolinë me mysafirë.

Në pyetjen e kryetari i trupit gjykues : *“deklaroni se keni pas raporte të mira me E., rastet kur vonoheshit si i keni justifikuar ? ”*

Dëshmitarja: *mundoja të justifikoja, se kemi pas edhe probleme.*

Kryetari i trupit gjykues, : *cilat janë arsyet që jeni justifikuar?*

Dëshmitarja: *se dola me pi kafe, dhe gjëra të tjera.*

Dëshmitari Xh.G., e din se është ftuar për rastin e L.lt, punon si taksist, në Ferizaj dhe se numri i tij telefonit është E.D. e njeh që një vit, në bazë të nënës së E.it, ngase nënën e tij që 10 vite e njeh. Nuk e din nëse ka punuar E. S.B. e njeh në bazë të E.it, ka punur ; kafe, edhe e ka bart me taksi nga kafja deri në banesë. E. herën e fundit dita nuk i kujtohet ose data sakte, se kur ka ndodhe, por e di që se e ka qu deri në Prizren dhe se ora ka qenë pas 12 të natës se e ka nënën e sëmurë. Të gjitha rrugët ose restorantet që janë në Ferizaj i dinë, se punon taksist, dhe se dinë edhe motelin “...” i cili gjendet në magjistrale Ferizaj - Prishtinë

Prokurori i shtetit: a e ke transportu E. dhe S. ne restoran ...?

Dëshmitari: Jo asnjëherë.

Prokurori i shtetit: (lexon procesverbalin e dhënë nga dëshmitari në hetuesi në Prishtinë të datës 22.04.2013, faqja e dytë pyetja e parafundit “a e keni dërguar S. në ndonjë hotel ju kanë pyet, ju jeni përgjigj se po e kam dërguar 2 ose 3 here, në cilin hotel, të gjitha herë e kam dërguar në restoran ...”

Prokurori i shtetit: në pyetjen tjetër të hetuesve keni thënë: “Sa ka qenë transporti që e ke qu S. në ...? Ju jeni përgjigjur se ka qenë 5 euro”.

Prokurori i shtetit: Kush e ka ba organizim për me e transportu në restoran ...?

Ju keni thanë çdo herë E., keni thënë në deklaratë që E. ju ka thënë në telefon juve se “hajde ku kam qenë unë edhe merre S.”, edhe unë me E. kemi nejt te “...”.

Dëshmitari: Nuk kam thënë ashtu se nuk ka ndodhë.

Prokurori i shtetit: A ke fol me E. ti me e dërgu në restorant ...?

Dëshmitari: Jo kurrë.

Prokurori i shtetit: A keni nënshkrua në këtë deklaratë? I tregon deklaratën e dhënë nga dëshmitari në hetuesi në Prishtinë.

dëshmitari: Po nënshkrimi im është.

Prokurori i shtetit: pse e keni nënshkrua?

dëshmitari: Ashtu është dashtë.

Në pyetjet e trupit gjykues ka deklaruar: se Elsin e njehë në bazë të nënës së tij, qe 10 vite, në një lokal ku punonte ajo. Si taksist i ka shërbyer asaj kur ka pas nevojë për taksi, ka pasur raporte te mira dhe ka qenë edhe në shtëpi të ata në Shqipëri. Kemi krijuar miqësi edhe kam qenë në shtëpinë e saj në Tirane dhe atë dy herë. Një herë e kam dërgu L.1 me S., një herë për shkak të miqësisë kam shkuar te ta.

Kryetari i trupit gjykues: A kontakton shpesh me të a keni kontakte ende me të?

Dëshmitari: Jo, vetëm kur ka ra rasti, ndonjë herë kur ka ardh me e taku L.1 kemi pi kafe.

Gjithashtu deklaroi se herën e fundit qe e ka pa L.2-nënë e E. është dita e djeshme në Ferizaj, dhe atë në rrugën “Rexhep Bislimi”:

Dëshmitari : Gjatë bisedës që pata me të më than se keni pas ftesë nga gjykata për seance gjyqësorë, dhe nuk keni shkuar, ndërsa unë iu jam përgjigje se nuk e kam ditë se më kanë ftuar, mirë po më tepër nuk kemi biseduar për këtë”. Ajo kishte ardhur për shkak të seancës gjyqësorë që po mbahet për djalin e saj, Po të gjithë ata që i kam bart i konsideroj si

familje, përfshirë këtu edhe L.2 ku i ka shërbyer shumë herë me taksi, gjithashtu se unë do ju kisha ndihmuar nëse kanë ndonjë hall ose telashe po të kisha mundësi do ta bëj.

Kryetari i trupit gjykues: L.2, ju e konsideroni si familje?

Dëshmitari: Po e konsideroj ashtu si familje se kam punuar mirë me të.

Deklaron se S., së bashku me L.2 i ka dërguar deri në Shtime, nga dita e fundit, deri më sot, për veq kësaj që e potencova më lart nuk e ka vozitë S. prej kur është mbyll E., gjithashtu deklaron se asnjëherë nuk ka ndodhe që S. të më thirr mua drejtpërdrejt për shërbimet e taksit, por kjo gjithe ka ndodhe pasi që e ka thirre E., dhe pagesën e ka bërë çdo herë.

Gjithashtu nuk kam pas numër të S. vetëm të E. t, dhe se emri i kafenesë ku ka punuar S. është quajt "...", gjithashtu deklaron se L.1 nuk e kam takuar te kafe "...", dhe ka pas disa raste ku e kam taku poshtë nën kafeteri "...", ka qenë një çajtoze edhe janë takua aty , gjithashtu ka pas rast kur L.1 me ka thirr me numra tjerë kur ska pas kredit, se zërin e tij e njoh mirë, deklaron se pronar i kafes ... ka qenë H.K., dhe e njoh që 10 (dhjetë) vite, dhe gjithmonë e kam njoh si pronar të kafes, nuk kemi pas raporte të afërta me të e kam njoh si person.

Dëshmitari E.I., nga Ferizaj, me profesion taksist, i cili i ka shërbyer disa herë viktimës me taksi, deklaron se si taksist punon nga vitet 1990. Kryesisht ka shërbyer në Ferizaj, thekson se S. e kishte marrë dy ose tre herë nga udhëkryqi afër IPKO. E. e kishte njoftuar një ditë, kur i kishte kërkuar shërbim për taksi dhe i kishte kërkuar numrin e telefonit për hera të tjera, ku e kishte thirr disa herë për shërbime të tyre. Pasi që e kishte thirr E. një herë në telefon dhe i ka kërkuar të vij ta marr S., pasi që viktima kishte hypë në taksi dhe i ka treguar destinacionin për në shitore, ndër kohë e kishte thirr dikush në telefon ku ajo i ka kërkuar që ta dërgoj në restorant "...", dhe e kishte lënë aty, thekson se E. e kishte thirr disa herë për ta dërguar S. në vendin e punës, po asnjë herë në restorant "...". Sa herë që e ka dërguar S. në restorant "...", nuk e ka pritur e ka lënë aty dhe ka shkuar ta merr prapë, pagesa për këtë shërbim taksie ka qenë nga 5 (pesë) deri 6 (gjashtë) € nga afërsia ku banonte S. deri në restorant "...". Deklaratën e dhënë në hetuesi ka qenë nën presion gjatë gjithë kohës, dhe se ka qenë vonë atë natë, pasi që deklarata e dhënë në hetuesi dhe ajo në shqyrtim gjyqësor nuk janë të njetat, thekson se nuk ka qenë mirë me shëndet, dhe se ka probleme me të pamurit, nuk e ka lexuar deklaratën e dhënë në hetuesi vetëm e ka nënshkruar. Është takuar sot me S.,

nënë e E.it dhe H. në kafeterinë përballë gjykatës, ku kanë pirë kafe dhe kanë biseduar në lidhje me rastin.

Dëshmitari M.Z., nga fshati Komuna e Lipjani, dhe se numri i tij i telefonit është ..., deklaron se ka ardhur shpesh në Ferizaj, kafeterinë “...” nuk e din me emër cila është, por e din se ku gjendet, pasi që ka qenë aty, duke shtuar se ka hyrë në kafeteri, dhe ka porositur një pije, tregon se si S. ka ardhur dhe është ulur në tavolinë tek ai, dhe ka qëndruar me të 20 minuta. Kanë biseduar (për me ba pushim), se ideja ka qenë e të dyve për të kryer marrëdhënie, ajo ia ka propozuar se mund të shkojnë në restorant “...”, pasi që është shprehur se tjetër kund nuk shkon. Për këtë i ka kërkuar të holla në shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, nuk e din se me çka ka ardhur ajo deri te restorant “...”, pasi që ai ka qenë në dhomë dhe se e ka thirrë në telefon, i ka thënë se nuk e ka për obligim të i’ a paguaj edhe taksin, gjithashtu deklaron se dhomën e ka paguar 15 (pesëmbëdhjetë) €, shton se deri sa kanë pirë pijet në kafeterinë “...” kanë biseduar dhe kanë bërë marrëveshjen për të shkuar në restorant “...”.

Dëshmitari H.D., nga fshati ... Komuna e Drenasit, në dëshminë e tij ka deklaruar se ka qenë në Ferizaj dhe se data apo koha nuk i kujtohen, me kushëririn e tij B.G., rrugës duke kaluar me veturë kanë venë re dy femra, ku i kanë thirrur nga kafeteria “...”, pasi që kanë hyrë në kafe, kanë porositur pijet, dhe në tavolinë i’u kanë ardhur dhe janë ulur me ta, njëra është prezantuar si S., dhe se i kanë shkëmbyer numrat e telefonit, dhe e B.G. i ka pëlqyer S., dhe ajo ka propozuar të shkoj me të në restorant “...”, të dy kanë vazhduar rrugën për në restorant “...”. Ndërsa S. ka shkuar me taksì, shton se atë natë vetëm B. ka kryer marrëdhënie me të, ndërsa ai ka pritur poshtë në restorant, dhe se i ka kërkuar kushëririn të tij 50 (pesëdhjetë) €. Ndërsa thekson se ka ardhur prapë pas disa ditësh vetëm, ku S. i ka thënë se e din se ku punon, dhe se hajde mbas orarit të punës, fillimisht ka shkuar në kafeterinë “...”, ku S. i ka thënë se ti e din se ku gjendet restorant “...” dhe më prit aty, shton se pas dy javësh ka ardhur prapë, për marrëdhënie seksuale i ka kërkuar 50 (pesëdhjetë) € thekson se të akuzuarin nuk e njeh, dhe se S. i ka kërkuar e para edhe B.t që të kenë marrëdhënie seksuale.

Dëshmitari B.G., në shqyrtimin gjyqësor ka deklarua se në Ferizaj ka ardhur së bashku me kushëririn e tij H.D., ka qenë për afërsisht ora 23:00 kur kanë hyrë në kafeterinë “...”, ku S. ka ardhur në tavolinë ku ju ka sjellë pijet dhe ka kërkuar të ulet me ta. Pijet për ne kanë kushtuar një euro, ndërsa asaj (S.) tre euro. Kanë filluar të bisedojnë fillimisht se ku

punojnë, thekson se S. i'u është ankuar se paga ku punon është e ulët dhe ka kërkuar ti ndihmoj me 50 (pesëdhjetë) €. Ndërkohë ka marrë telefonin e tij, dhe ka regjistruar numrin e saj, edhe ajo ka regjistruar numrin e tij në telefonin e saj. Kanë arritur marrëveshje për të shkuar në restorant "...", dhe se janë takuar atje, ku ai ka marrë një dhomë dhe e ka pritë lart, ndërsa ajo kishte ardhur me taksì, dhe se nga ajo natë më nuk është takuar me të.

Dëshmitari A.S.1, punon në motelin "...", nga ora 21:00 deri në 07:00, të mëngjesit, dhe se në kohën kur ka ndodhur rasti me datë 18.04.2013, ka punuar si pastrues, ndërsa recepsionisti A.S.2 kishte munguar në punë atë natë, pronari i ka kërkuar që punoj atë natë në recepsion, deklaroi se kishte ardhur S. në restorant "...", atë natë, dhe se nuk i kishte dhënë ndonjë dokument identifikues, dhe se ai si punëtor nuk mund ta obligoj klientin që ti jep dokumentin identifikues me zor, dhe se ka ardhur me taksì. Ndërsa dhomën e ka paguar një mashkull, gjithashtu thekson se nuk i kujtohet nëse ka qenë vetëm ajo apo me dikë tjetër.

Dëshmitari S.Sh., nga fshati ... - komuna e Bujanocit, me vendbanim në Ferizaj, deklaroi se e dinë se ku gjendet kafeteria "...", me emër jo por si vend e din pasi që ka qenë një herë atje, gjithashtu deklaroi se të dëmtuarën e njeh pasi që e ka takuar në kafeterinë "...", pasi që një ditë nga një lokal përballë e ka vërejt se është një kafeteri dhe ka shkua pastaj. Duke shtuar se S. kishte ardhur në tavolinë e ka shërbyer me pije dhe i ka kërkuar që të ulet me të, dhe ti paguaj një pije, dhe se është ulur ku kanë qëndruar bashkë 20 minuta, dhe gjatë bisedës kanë shkëmbyer numrat e telefonit, dhe kanë bërë marrëveshje për marrëdhënie, ku i ka thënë se është e lirë dhe se janë takuar në restorant "...", ku ajo ka kërkuar të shkojnë në atë vend, dhe se e ka paguar 50 (pesëdhjetë) €, shton se edhe një herë tjetër është takuar me të në restorant "...", por marrëveshja është bërë nëpër mes telefonit dhe se ka qenë më në kafeterinë "...", deklaroi se dy herë ka qenë me të në restorant "...", dhe se më nuk e ka takuar. Gjatë pyetjeve sqaruese ka deklaruar se herën e dytë janë marrë vesh për mes telefonit, e nuk ka qenë me të në restorant "...", ndërsa herën e parë është takuar në restorant "...", ku edhe kanë bërë marrëveshjen, ndërsa ora kur kanë shkuar në motel ka qenë diku 23:30 ose 24:00.

Dëshmitari Z.LL.2, nga Podujeva, ka deklaruar se S. e ka takuar në kafeteri, dhe se kishte ardhur me një shok në Ferizaj, fillimisht ju kishte shërbyer me pije dhe më pas e kanë ftuar të ulet me ta në tavolinë. I kujtohet se pija (S.) ka kushtuar 6 (gjashtë) euro, i ka kërkuar, numrin e telefonit dhe po atë natë e kanë bërë marrëveshjen, herën e parë janë takuar

në një nga kafeteritë e qytetit emri i së cilës nuk i kujtohet, dhe se atë ditë nuk kanë shkuar në restorant "...", herës tjetër kanë kontaktuar prapë në telefon dhe janë takuar para restorantit diku rreth orës 11:00 të paradites, ku ajo kishte ardhur me taksi dhe kanë shkuar në dhomë, dhomën e kishte paguar 10 (dhjetë) €, ndërsa atë 100 (njëqind) €. Gjithashtu shton se kanë biseduar në telefon edhe dy herë tjera por nuk janë takuar më, deklaron se të akuzuarin H.A. e njeh si pronar të kafes, S. i kishte thënë se ai dhe gruaja e tij janë pronarë të kafes ku punonte.

VLERËSIMI I DËSHMIVE DHE PROVAVE

Trupi gjykues konform nenit 365 par. 2 të KPPRK-së vlerësoi provat një nga një dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke, dhe pas këtij vlerësimi vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv.

Dëshminë e të dëmtuarës S.B., trupi gjykues e vlerësoi me kujdes të veçantë, e njëjta kishte një histori divorci me një bashkëshort tjetër dhe me të cilën kishte edhe fëmijë. E papunë dhe pa mjete të mjaftueshme për jetesë për vetën dhe për ti mbështetur fëmijët e saj. Kishte krijuar bashkësi jashtëmartesorë me E., dhe më pas i njëjti e kishte sjell në Kosovë, ku edhe i kishte gjetur punë bazuar në lidhjet që kishte ai dhe nëna e tij pasi me herët kishin qenë në Kosovë.

Në deklaratimet gjatë dëshmisë së saj qartazi merr pozicione favorizuese ndaj të akuzuarit, duke u përpjekur ta binde trupin gjykues, se krejt çka kishte bërë përkatësisht ofrimin e shërbimeve seksuale e kishte bërë vetë vullnetarisht dhe madje edhe pa dijeninë E..

Dëshmia saj në këtë aspekt është e kundërt me dëshmitë e tjera, si dhe me provat materiale respektivisht transkriptet e komunikimeve të saj dhe të i akuzuarit. I cili çdo herë ishte kujdesur që ti siguronte taksi, e priste në afërsi të motelit siç ishte tek restoranti "...". Komunikimi i rregullt gjatë intervalit kohor para dhe menjëherë pas kryerjes së shërbimeve seksuale tregon se E, jo vetëm se ishte në dijeni, por në mënyrë aktive organizonte transportin duke thirrur shërbimet e taksive për ta dërguar deri në vendin e ofrimit të shërbimeve seksuale.

Rrethanat e tilla tregon se i i akuzuari kishte një kontrolle maksimal ndaj të dëmtuarës, ekzistimi i këtyre fakteve në këtë aspekt e bënë të pabesueshëm, ndërsa në aspektet e tjera pohimi i të cilave drejtpërdrejtë nuk i inkrimon të akuzuarit konsiderohet e besueshme, pasi ofrimi i shërbimeve seksuale, duke filluar nga bisedat paraprake, arritja e marrëveshjes dhe më pas realizimi i saj në motelin ..., përputhet edhe me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë të dëgjuar të cilët ishin personat që kishin paguar për këto shërbime.

Dëshmia e dëshmitari Xh.G., dëshmia e tij në shqyrtimin gjyqësor ishte substancialisht e kundërt me dëshminë e dhënë në procedurën hetimore. Kjo nuk mund të shpjegohej se kishte të bënte me mos kujtim të fakteve, si rezultat i kalimit të kohës dhe zbehjes së kujtesës, por me ofrim të ndryshëm të fakteve të cilat në esencë sipas bindjes së tij nuk do ta inkriminonin të akuzuarin E.. Dëshmia e tij në shqyrtimin gjyqësor haptazi manifeston vullnetin për ta ndihmuar dhe solidarizuar me këtë të i akuzuar, si rezultat i njohjeve dhe miqësive që kishte veçanërisht me nënën e të akuzuarit E., të quajtur L.2, së cilës i kishte ofruar më parë shërbime të taksive dhe kishin krijuar miqësi të konsoliduar sa që edhe kishte shkuar në Shqipëri për ta vizituar.

Takimi i pohuar me L.2, vetëm një dite para ditës kur duhet të dëshmonte, tregon rrethanat e krijuara influencuese dhe njëkohësisht gatishmërinë e këtij dëshmitari për të iu ofruar ndihmë dhe mbështetje me ndryshim të deklaratave, për hirë të mikës së tij për të i'a shpëtuar djalin nga një dënim burgimi që potencialisht pritej, dhe se sa kishte respekt për miqësinë e tij tregon edhe deklarimi se *“ L.2 e konsideronte edhe si familje ”*.

Në botëkuptimin e tij, ky dëshmitar, po e mbi peshonte se ishte me i vlefshëm që të ndihmohen miqtë, se sa obligimi ligjor për të thënë të vërtetën, për të cilën edhe kishte bindje se përkundër deklaramit jo të vërtetë, nuk do ti ndodhte gjë respektivisht nuk po parashikonte se mundë të pësonte ndonjë pasojë serioze për dëshmi të rrejshme.

Rrjedhimisht dëshmia në shqyrtimin gjyqësor është e pabesueshme dhe në thelb e anshme, e orientuar në përpjekjet që të jetë sa më favorizuese për të akuzuarin E.D., dhe që nuk kishte lidhje logjike me realitetin e ndodhur më parë.

Dëshmitari E.I., dëshmia e këtij dëshmitari në shumë aspekte ishte kundërthënëse me dëshminë e mëparshme të dhënë gjatë procedurës hetimore, e në veçanti dallimet kur ishin në pyetje thirrjet që i kishte bërë E., për ta marrë S., dhe për ta dërguar në motelin ..., siç kishte deklaruar në procedurën hetimore, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor përgjigjet e tij ishin mohuese dhe gjatë ballafaqimit me dëshminë e dhënë në procedurën hetimore, është munduar të shpjegoj se e vërteta është ajo që po e deklaroi në shqyrtim gjyqësor, ngase në hetuesi ka qenë i emocionuar. Arsye të cilat trupi gjykues i vlerëson si jo bindëse, dhe se deklaratimet e tij në shqyrtimin gjyqësor ishin jo të lidhura, të palogjikshme, dhe nuk pasqyrojnë zhvillimin real të ngjarjes, për dallim dëshmia në hetuesi shpjegonte në mënyrë episodike zhvillimin e ngjarjes, faktet ishin të lidhura në mënyrë kronologjike dhe logjike, rrethanat të cilat i potencojnë janë thjesht tregim i personit që i ka përjetuar. Në kohën e dhënies dëshmitari nuk kishte kontaktuar me persona nga të cilët do të mund të influencohet dhe i zënë në befasi po rrëfente të vërtetën. Rrjedhimisht kjo dëshmi e mëparshme, sipas trupit gjykues, është e vërtetë dhe bindëse, ndërsa dëshmia në shqyrtimin gjyqësor ishte dhënë një kohë relativisht të gjatë pas ngjarjes, kishte kontaktuar me shumë persona, përfshirë edhe familjarët e të akuzuarit dhe dëshmia e tij në shqyrtim gjyqësor ishte një përpjekje për të qenë sa më e favorshme dhe joinkriminuese për të akuzuarin E..

Dëshmitë e dëshmitarëve M.Z., H.D., B.G., A.S.1, S.Sh. dhe Z.LL.2, për shkak të pakontestueshmërisë dhe homogjenitetit të deklaratimeve trupi gjykues, e konsideron si të mjaftueshme që të bëjë një përmbledhje të përbashkët të vlerësimeve të këtyre dëshmimeve. Të njëjtat ishin identike me dëshmitë e tyre të dhënë në hetuesi, të pakontestuara dhe mbështeten edhe nga dëshmitë e siguruar nga transkriptet e përgjimeve telefonike dhe në lidhjen logjike me dinamikën e zhvillimit të ngjarjeve.

Të gjithë kanë shpjeguar rrethanat e njohjes me të dëmtuarën në restorantin “...” në Ferizaj, bisedat dhe marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve seksuale, vendin përkatësisht se të njëjtat pastaj janë kryer në motelin “...” në Ferizaj, dhe shumën e parave të cilat i kanë paguar në emër të këtyre shërbimeve. Dëshmitë e tyre i vlerëson si të besueshme dhe të sakta, dhe se vërtetësia e tyre nuk vihet në pyetje nga ndonjë dëshmi tjetër.

Raporti i masave të fshehta hetimore – përgjimi i telekomunikimit për numrat e telefonit: numri i të dëmtuarës: ..., numri i të akuzuarit E.D.numri i taksistit E.I.

Me datë 19.03.2013, në ora 15:57, viktima (S.) kontakton me të dyshuarin (E.) në numri e telefonut

S.: he qa ki

E.: qydh qa ki ka je tu ba aty

S.: qe tu nejt jam

E.: po tre ora ti me atë a

S.: jo more çfar

E.: po qa, nuk kuptohet se qfar i thot mirpo i bërtet me zë të lart, qe pare erdha prap aty te gjeta me ate bosh

S.: jo more une isha aty, është fjala për marrdhënie seksuale me një klient

E.: po a hajt

S.: po hajt.

Vërehet qartë se i dyshuari E. ka kontroll të plot mbi S. gjë që vërehet edhe në këtë bisedë telefonike duke e qortuar që mos të rrij kohë të gjatë me persona të njëjtë duke i shoqëruar në tavolinë

Me datë 24.03.2013, ora 17:14, viktima (S.) kontakton me të dyshuarin (E.) në numrin e telefonit ...

S.: he qa po ban

E.: qa je tu ba

S.: qe jam ul aty me pi ni pije hajt

E.: po a hajt

S.: hajt sa te mbaron hajt

Në bazë të kësaj bisede vërehet se për çdo lëvizje S. është e datyruar që ta njoftoj E.

Me datë 25.03.2013, në ora 00:35, viktima (S.) kontakton me të dyshuarin (E.) në numri e telefonit ...

E.: he

S.: qe po pres taksin, per pes minuta me tha qe vjen

E.: ani hajt

Me datë 25.03.2013, në ora 00:42, viktima (S.) kontakton me të dyshuarin (E.) në numrin e telefonit

E.: he

S.: he qe jam ne taksi une hypa, ku je ti

E.: po une te picerija jam, po shko ti te shpija

S.: hajde per dy sekonda atje a

E.: ku te shpija a po hajt .

Gjithashtu konstatohet komunikimi i të dëmtuarës personat që ju ka ofruar shërbimet seksuale, përkatësisht numrat e dëshmitarëve të dëgjuar, M.Z., H.D., B.G., A.S.1, S.Sh. dhe Z.LL.2.

Nga raporti i përgjimit të telekomunimit nga numrat e telefonave të lartcekur konstatohen komunikimi i të akuzuarit E., me të dëmtuarën dhe njëkohësisht konstatohet dijenia për veprimtarinë prostitucionit të dëmtuarës, por edhe kontrolli i plotë për veprimet e të dëmtuarës duke përfshirë edhe kohën e shkuarjes, qëndrimin në motel.

Transkriptet e tilla pasqyrojnë komunikimet që kanë ekzistuar, dhe japin një panoramë të saktë të të ngjarjeve të zhvilluara, dhe njëkohësisht janë të vërteta të sakta, dhe si të tilla trupi gjykues i vlerëson të besueshme.

Dokumentacioni për të dëmtuarën S.B., leja e punës e lëshuar nga Ministria për Mirëqenie Sociale e Republikës së Kosovës, konstatohet se e dëmtuara posedonte leje pune e vlefshme prej datës 11. 07. 2012 deri më 11. 07. 2013. Kontratën e punës e lidhur mes D.P.H ... dhe të dëmtuarës e nënshkruar më 04. 07. 2013 mes të të akuzuarit H.A. dhe të dëmtuarës për vendin e punës kamarierë.

Raporti nga Njësia e Hetimeve Tatimore me nr. .../13 të datës 20. 08. 2013 dhe nga administrata tatimore për të akuzuarin H.A., konfirmojnë se Kafe - Bar "...” është regjistruar me NRB ..., FIN ... në rrugën ... ne Ferizaj, është regjistruar më datë 28. 07.

2008, ndërsa e dëmtuara S.B. nuk figuron se është punëtore e regjistruar në këtë ndërmarrje hotelier dhe rrjedhimisht as që paguante sigurimet dhe kontributete tjera ndaj shtetit.

Raportet financiare nga bankat komerciale të Kosovës për të akuzuarit në ..., ..., Ndërsa i akuzuari H.A., ka llogari të hapura në ..., llogari të hapura si person fizik dhe një në emër DPH "...". Ndërsa E.D. ka llogari të hapur ne ... si dhe raporti i ... me nr. ... të datës 27. 08. 2013 me të cilën konstatohet se ka dërgua para në Shqipëri nga data 19.03.2012 deri më datë 03.04. 2013 në shuma kryesisht nga 50 (pesëdhjetë) €, dhe shuma më e lartë që ka dërgua përnjëherë është 300 (treqind) €.

Provat e lartcekura janë të besueshme pasi që të dhënat janë të lëshuara nga organet kompetente në kuadër të autorizimeve të tyre ligjore, dhe nuk ekziston ndonjë rretnaë që do vënte në pyetje vërtetësinë, saktësinë dhe objektivitetin e tyre.

Analiza e Ligjit Material - Penal

Vepra penale mundësimi i prostitucionit nga neni 241 par. 1 të KPRK-së

“ Kushdo që rekruton, organizon, ndihmon ose kontrollon personin tjetër për qëllime prostitucionit dënohet me gjobë dhe me burgim deri ne tre (3) vjet ”.

Kryes i veprës penale mundë të jetë çdo person dhe kjo vepër penale hynë në kategorinë e veprave të ashtuquajtura *delicta communia*.

Nga aspekti subjektiv vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje direkte, kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm dhe duhet të dëshiroj ardhjen e pasojës kriminale.

Veprimet inkriminuese janë: *“rekrutimi, organizimi ose kontrollimi i personit tjetër”*, mjafton që të ekzistojnë vetëm njëri nga veprimet për t’u konsideruar se është kryer vepra penale, por munde te ekzistojnë edhe kumulativishtë dy apo më tepër veprime, gjithherë të ndërmarra me qëllim të prostitucionit.

Në rastin konkret nga provat prezantuara në veçanti nga transkriptetet telefonike dhe të mbështetura edhe nga dëshmitarët taksistët, provohet përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari E.D., kishte kontroll tek e dëmtuara, duke siguruar shërbimet e taksive deri në motelin ..., ku e

dëmtuara kryente shërbimet seksual për klientët, me të cilët arrinte marrëveshje për çmimin që do të paguanin për këto shërbime. I akuzuari çdo herë kontaktonte dhe i paguante taksistët, kishte kontakte të rregullta telefonike me të dëmtuarën veçanërisht pas kryerjes së shërbimeve seksuale.

Rrethanat e tilla qartazi manifestojnë kontrollin dhe drejtimin e aktivitetit të prostitucionit që ofronte e dëmtuara, rrjedhimisht edhe kontrollin mbi të.

Vepra penale : Ofrimi i lokaleve për prostitucion neni 242 i KPRK-së

Paragrafi 1. Përcakton “ Kushdo që me dijeni ofron lokalin, qoftë si pronar i lokalit, qiradhënës, qiramarrës, shfrytëzues ose personi përgjegjës, personit tjetër për qëllime të prostitucionit ose mundësimi i prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim, deri 3 (tre) vjet”.

I akuzuari H.A., ishte pronar i restorantit “...” ku e dëmtuara punonte si kamariere, dhe ishte vendi ku arrinte marrëveshjet me klientët për ofrimin e shërbimeve seksuale me pagesë. Fakti se klientët ishin pothuajse të gjithë nga komunat e tjera (jo nga Ferizaj) dhe nuk vizitonin këtë restorant se ofronte ushqim apo muzikë të mirë, apo se kishte ndonjë emër të njohur si restorant që për vlerat e tij i’ a vlente të vizitohej, por ishte thjeshtë se këtu mundë të gjendet femra e cila ofronte shërbime seksuale, dhe kjo ishte arsyeja e vetme logjike se pse keta vizitor ishin mysafir të këtij restoranti marginal në Ferizaj.

A dinte i akuzuari i lartcekur, se e dëmtuara S.B., po ofronte shërbime seksuale me pagesë dhe se në restorantin e tij po i bënte marrëveshjet për këto shërbime ?

Duke qenë pronar i një restoranti të vogël, dhe njëkohësisht menaxher i tij në përditshmëri;

- që vizitohej nga mysafir - klient të pakët;
- fakti se vizitorët ishin nga komunat e tjera;

- pijet të cilët i paguanin në rastet, kur e dëmtuara i shoqëronte mysafirët ishin më të shtrenjta;
- hapësira e vogël e restorantit me tavolina të pakëta dhe në afërsi;

Rrethanat e tilla në tërësinë e tyre tregojnë se i i akuzuari kishte çdo gjë nën kontroll, dhe hollësisht dinte për veprimtarinë që ushtronte e dëmtuara, dhe se e njëjta punën e kamariere po e ushtronte vetëm formalisht, dhe në funksion të lehtësimit të ushtrimit të veprimtarisë së prostitucionit pasi që në këtë mënyrë kishte mundësinë që të komunikonte drejtpërdrejtë me klientët dhe ti arrinte marrëveshjet për kohën, vendi dhe çmimin për shërbimet seksuale që do të ju ofronte.

I akuzuari H., lokalën e tij po e ofronte i motivuar nga arsyeja e përfitimit që realizonte nga çmimi i pijeve më të larta që paguanin mysafirët gjatë shoqërimit me të dëmtuarën. Duke pasur profesion veprimtarinë e një hotelieristi që po ushtronte shumë vite më parë, dhe që krenohet me një përvojë të gjatë në këtë fushë.

Do të ishte e pabesueshme, madje surprizuese që të besohet se ky nuk po dinte për marrëveshjet që i bënte e dëmtuara, nga rrethanat e shpjeguara më lartë mund të konsiderohen si veprime konkludente, të cilat nxjerrin në sipërfaqen ekzistimin e një marrëveshjeje mes këtij të akuzuari dhe të dëmtuarës që e njëjta të ushtronte këtë veprimtari, duke pasur në konsideratë se në këtë mënyrë po realizonin përfitime dukshëm më të larta se sikur që përfiton si pronar i një restoranti të zakonshëm dhe e dëmtuara sikur një kameriere.

Prandaj në veprimet këtij të i akuzuari formësohen të gjitha tiparet e veprës penale ofrimi i lokaleve për prostitucion nga neni 241 par. 1 të KPRK-së.

Përcaktimi i Dënimit

Me rastin matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit neni 73 dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit

në kuptim të nenit 74 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të i akuzuarin E.D. mori shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit duke e përfshirë edhe planifikimin dhe paramendimin e të akuzuarit duke sjell të dëmtuarën në Kosovë nga Shqipëria për ushtrimin e prostitucionit, shfrytëzimin e gjendjes jo të mirë ekonomike dhe personale të dëmtuarës dhe atë faktin se kishte lënë fëmijë të mitur, dhe të cilët po mundohej që ti mbështeste financiarisht.

Si rrethanë lehtësues vlerësoi se i akuzuari është papunë dhe pa burime jetese të mjaftueshme, ashtu që karakterizohet me paqëndrueshmëri dhe pasiguri ekonomike për të ardhmen.

Në kuptim të gjitha këtyre rrethanave i shqipton dënim me burgim dhe dënim me gjobë në kohëzgjatje dhe lartësi të përcaktuar si në dispozitiv, me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm në raport me peshën konkrete të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes dhe i përgjigjet personalitetit kryesit dhe njëkohësisht me të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-së si në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale

Gjithashtu në kuptim të nenit 71 të KPRK-së i ka shqiptuar dënimin plotësues dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës, dhe atë në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, duke vlerësuar se karakteristikat personale e të akuzuarit tregojnë se ekziston rreziku se po të vazhdonte me kryerjen e veprave të tilla apo të ngjashme, njëkohësisht i akuzuari nuk ka ndonjë lidhje me Republikën e Kosovës, që do mund të ishin pengesë për dëbim.

Ndërsa për të akuzuarin H.A., si rrethana rënduese vlerësoi se ka keqpërdorë veprimtarinë hoteliere për të mundësuar ushtrimin e prostitucionit, si rrethana lehtësuese vlerësoi se nuk ka të dhëna që të jetë i dënuar më parë mbi bazën e këtyre rrethanave i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje dhe gjobë në lartësi të përcaktuar si në dispozitiv me bindjen se një dënim i tillë është në harmoni me peshën e veprës penale konkrete, rrethanave të kryerjes, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe me të njëkohësisht me të arrihet qëllimi ndëshkimor si në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale.

Gjithashtu në kuptim të nenit 66 të KPRK-së i ka shqiptuar dënimin plotësues – ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës- ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë

hoteliere në kohëzgjatje prej 2(dy) vite, pasi është e pritshme se në të ardhmen mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.

Kërkesat Pasurore Juridike dhe Shpenzimet e Procedurës Penale

E dëmtuara S.B., nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike. Ndërsa në kuptim 451, 452 dhe 453 të KPRK-së trupi gjykues ka obliguar të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën secili veç e veç nga 100 (njëqind) €, i cili është përcaktuar duke pasur parasysh shkallën e komplikueshmërisë së çështjes penale dhe gjendjen ekonomike të akuzuarve.

Nga e sipër cekurat është vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.215/13

Më 06 dhjetor 2013

Procesmbajtësja,
Ardrita Ymeri

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Bashkim Hyseni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ushtrimi i ankesës Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate